

Në bazë të nenin 4 të Ligjit mbi taksat administrative (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 18/19), nenin 38 paragrafi 1 dhe nenin 185 paragrafi 3 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi”, Nr. 2/18, 34/19, 38/20, 50/22 dhe 84/22) dhe neni 58 paragrafi 1 pika 8 të Statutit të Komunës së Ulqinit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat Komunale”, nr. 48. /19), me miratimin paraprak të Qeverisë së Malit të Zi, Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në seancën e mbajtur më 31.03.2023., ka sjellë:

V E N D I M

mbi taksat lokale administrative

Lënda

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet pagesa e taksës lokale administrative për shkresa dhe veprime pranë organeve të Komunës së Ulqinit (në tekstin e mëtejme: „komuna“).

Përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjinore

Neni 2

Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë vendim për gjininë mashkullore nënkuptohen edhe për personat fizik të gjinisë femërore.

Tarifat e taksës

Neni 3

Taksat lokale administrative paguhen në lartësinë e cila përcaktohet me Tarifën e taksave lokale administrative e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi (në tekstin e mëtejme: Tarifa e taksës)

Pagesa e taksave lokale administrative

Neni 4

Pagesa e taksave lokale administrative bëhet në llogarinë e pagesës të komunës, në përputhje me dispozitat të cilat rregullojnë mënyrën e pagesës e të ardhurave publike.

Realizimi i detyrimit të taksës

Neni 5

Detyrimi tatimor për taksat administrative lokale të shkaktuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi paguhet në përputhje me Vendimin për taksat administrative lokale (“Fleta Zyrtare e Republikës së Malit të Zi – Dispozitat Komunale”, numër 22/07).

Përfundimi i vlefshmërisë

Neni 6

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi pushon së vlefshmi Vendimi mbi taksat administrative lokale (“Fleta Zyrtare e Republikës së Malit të Zi – Dispozitat Komunale”, numër 22/07).

**Hyrja në fuqi
Neni 7**

Ky vendim hynë në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në "Fletën zyrtare të MZ – dispozitat komunale".

KUVENDI KOMUNËS SË ULQINIT

**Numër: 02-016/23-340/7
Ulqin, 31.07.2023**

**KRYETARI
Ardijan Mavriq**

TARIFA PËR TAKSAT LOKALE ADMINISTRATIVE

Të gjitha pagesat janë të paraqitura në euro (€).

I. PARASHTRIMET

Numri tarifor 1

Për kërkesë, lutje, propozim, paraqitje dhe parashtrim tjetër, nëse me këtë vendim nuk është ndryshe e përcaktuar.....**2,00**

Vërejtje:

Taksa sipas këtij numri tarifor nuk paguhet për parashtrimet e mëvonshme me të cilat pala kërkon vetëm trajtim më të shpejtë sipas kërkesës të dorëzuar më herët.

Taksa sipas këtij numri tarifor nuk paguhet për kërkesat për ushtrimin e të drejtës së premitë dhe regreset (inkurajimi i prodhimit bujqësor).

Numri tarifor 2

Për ankesa kundër aktvendimit të cilin e sjellë organi i administratës lokale dhe shërbimet, nëse me këtë vendim nuk është ndryshe e përcaktuar.....**4,00**

Vërejtje:

Taksa sipas këtij Numri tarifor paguhet për ankesat në aktvendimet të sjellura sipas detyrës zyrtare dhe sipas kërkesës së palës, nëse me këtë vendim nuk është ndryshe e përcaktuar.

II. PARALAJMËRIMI

Numri tarifor 3

Për paralajmërim me të cilin paguesi ftohet të paguajë taksën**2,00**

III. AKTVENDIMET

Numri tarifor 4

Për të gjitha aktvendimet e organit të administratës për të cilat nuk është përcaktuar taksë e veçantë.....**3,00**

Vërejtje:

Nëse sillen një aktvendim sipas kërkesës së më shumë personave, taksa sipas këtij Numri tarifor paguhet aq herë sa ka persona të cilëve u dorëzohet aktvendimi.

Numri tarifor 5

1) Për ankesë kundër aktvendimit të administratës tatimore të bërë në procedurën tatimore në shkallë të parë.....**8,00**

2) Për aktet tatimore të cilat organi i Administratës Tatimore i sjell në procedurën tatimore me kërkesën e palës**10,00**

Numri tarifor 6

Për mjetet e jashtëzakonshme juridike.....**20,00**

IV. VËRTETIMET

Numri tarifor 7

Për vërtetimet të cilat lëshohen nga organet e administratës, nëse me këtë vendim nuk është përcaktuar ndryshe
.....3,00

Numri tarifor 8

Për certifikata nga evidenca publike të cilat i udhëheqin organet e administratës lokale dhe shërbimet, përveç për certifikata nga pika Tarifore 13, pika 1,2 dhe 3.....3,00

V. VËRTETIMET, TRANSKRIPTET DHE PËRKTHIMET

Numri tarifor 9

1) Për vërtetimin e nënshkrimit, transkripteve, autenticitetin e dorëshkrimit dhe kopjimet (nga çdo gjysëmtabak origjinali).....2,00;

2) Për vërtetimin e përkthimit paguhet 30% e taksës nga pika 1 e këtij numri tarifor.

Vërejtje:

1) Gjysëmtabak, në kuptim të këtij vendimi, do të thotë një fletë letre në të dyja anët e formatit normal të zyrës ose më të vogël.

2) Nëse dorëshkrimi, gjegjësisht kopja, vërtetimi i të cilës bëhet është në gjuhë të huaj, paguhet taksë e dyfishtë nga ky numër tarifor.

Numri tarifor 10

1.) Për kopjimin e akteve zyrtare të kryera nga organet e qeverisjes lokale dhe shërbimet lokale
.....
....3,00

2.) Për kopjimin e akteve ose dokumenteve të tjera në gjuhë të huaj nga gjysmëtabakët e origjinalit.....
.....3,00

Numri tarifor 11

Për vërtetimin e kontratës.....3,00

Vërejtje:

1. Vërtetohen vetëm kontratat për vërtetim e të cilave ligjërisht nuk kërkohet të vërtetohen në formën e shkresës noteriale.

Numri 12

Për vërtetimin e autorizimeve, pëlqimeve, deklaratave personale (deklaratë mbi përbërjen e familjes, certifikatën e jetës dhe të ngjashme3,00

VI. TAKSAT NGA FUSHA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Numri tarifor 13

1) Për certifikatë të martesës3,00;

2) Për certifikatë të martesës të destinuara për vende të huaja (certifikatë ndërkombëtare).....7,00;

0;

3) Për regjistrimin e mëvonshëm nga jashtë në regjistrin martesor sipas kërkesës.....**10,00;**

Numri tarifor 14

Për shkresa dhe veprime në procedurën e lidhjes martesore:

- në hapësirat zyrtare gjatë orarit të punës**20,00;**
- në hapësirat zyrtare jashtë orarit të punës**30,00;**
- jashtë hapësirave zyrtare.....**90,00;**

VII TAKSAT NGA FUSHA E PLANIFIKIMIT HAPSINOR, NDËRTIMIT TË OBJEKTEVE SI DHE MBROJTJES SË MJEDISIT JETËSOR

Numri tarifor 15

Për aktvendim që autorizon shndërrimin e pjesëve të përbashkëta ose të veçanta të një ndërtese banimi në një hapësirë pune gjegjësisht banesë.....**10,00**

VIII TAKSAT NGA FUSHA KOMUNALE

Numri tarifor 16

Për aktvendime me të cilat miratohet deponimi i materialit ndërtimor në sipërfaqe publike për kryerjen e punëve**30,00**

Numri tarifor 17

Për aktvendime me të cilat lejohet vendosja ose ndryshimi i firmës ose mbishkrimit.....**5,00**

Numri tarifor 18

Për aktvendime me të cilat përcaktohet shënimi i hyrjeve të reja në ndërtesat e banimit ose ato afariste.....**5,00**

Numri tarifor 19

Për dhënien e pëlqimit për regjistrim në regjistrin e mbledhësit ose transportuesit e mbeturinave.....**20,00**

Numri tarifor 20

Për aktvendimin për miratimin e kryerjes së punimeve në sipërfaqet publike.....**20,00**

Numri tarifor 21

Për dhënien e pëlqimit në planin e menaxhimit me mbeturinat e ndërtimit brenda kuadrit të kompetencave të organeve të administratës lokale.....**20,00**

Numri tarifor 22

Për lëshimin e aktvendimeve në procedurën e vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor dhe ate:

- Aktvendim mbi dhënien e pëlqimit në elaboratet mbi vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor10,00

IX TAKSA NGA FUSHA E KOMUNIKACIONIT DHE RRUGËVE

Numri tarifor 23

Për aktvendime me të cilat mbyllet rruga për shkak të punëve pranë rrugës.....10,00

Numri tarifor 24

Për aktvendime me të cilin lejohet pezullimi i qarkullimit në rrugët komunale me qëllim të zhvillimit të sportit apo aktiviteteve të tjera10,00

Numri tarifor 25

Për aktvendim me të cilin, në rrugët ku trafiku nuk mund të bëhet për automjete të mallrave dhe automjeteve hyrëse, lejohet trafikun vetëm për automjetet kur kryejnë furnizimin e objekteve të shitjes me pakicë dhe hotelierike.....10,00

Numri tarifor 26

Për aktvendimin me të cilin lejohet rezervimi i vendit për parkim.....10,00

X. TAKSA NGA FUSHA E SIPËRMARRËSISË

Numri tarifor 27

Për aktvendimet për përcaktimin e plotësimit të kushteve të hapësirave afariste në aspektin e pajisjeve për kryerjen e veprimtarive ekonomike dhe joekonomike, me kërkesë të palës:

1)	deri	në	50
m2.....			25.00
2)	nga 50m2 deri në 200m2.....		35.00
3)		mbi	200
m2.....			45.00
4)	Për vërtetimin e librit të ankesave në objektet dhe hapësirat ku ofrohen shërbimet turistike dhe gastronomike		3.00
5)	Për vërtetimin e librit të mysafirëve në akomodim.....		3.00
6)	Për lajmërimin e ushtrimit të shërbimeve turistike përfshirë edhe aktivitetet sportivo-rekreative dhe avanturistike si dhe shërbimeve turistike në turizmin nautik taksa.....		3.00
7)	Për lajmërimin e ushtrimit dhe ndërprerje së veprimtarisë së zanateve.....		3.00

Numri tarifor 28

Për aktvendimin për miratimin e kryerjes së transportit publik, transportit të udhëtarëve, transportit për nevoja vetjake,3,00

XI. TAKSAT NGA FUSHA E BUJQËSISË DHE UJËRAVE
Numri tarifor 29

Për marrjen e vendimit për përcaktimin e përmbushjes së kushteve dhe mënyrën e plotësimit të kushteve së drejtës në ujë:

- 1) Për aktvendim të përcaktimit të kushteve ujore**30,00**
- 2) Për aktvendim për përcaktimin e pëlqimit ujq**30,00**
- 3) Për aktvendim për lëshimin e lejes ujore**50,00**